



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**V E N D I M
Nr. 215, Datë 10. 02 .2012**

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm
motorrik ndaj palëve të treta (TPL)”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Rezana | KONOMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 10.02.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL);

VËREN SE:

1. Nisur nga një artikull në gazetën Panorama të datës 09/02/2012 me titull “Nga 1 Shkurti dyfishohet tarifa e sigurimit të makinave”, si edhe në informacione të tjera

dhënë në median televizive, sipas të cilave nga data 1 Shkurt 2012 midis operatorëve në tregun e sigurimeve është rënë dakord për të rritur çmimet e sigurimit të mjeteve motorrike, më datë 09.02.2012, Inspektorët e Drejtorisë së Mbikqyrjes dhe Hetimit të Tregut realizuan një monitorim të çmimeve duke realizuar kontakte me agjentët e shitjeve në këtë treg.

2. Nga monitorimi rezulton se kompanitë e sigurimit, aplikojnë çmime të njëjta për primet e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta që prej datës 1 Shkurt 2012 sipas tabelës si vijon:

Kategoria	Kapaciteti motorik,pesha ose numri i vendeve	Totali,lek
Motocikleta	Kapaciteti Motorik	
	Deri në 150 cm ³	4.100
	Mbi 150 cm ³	7,000
Autovetura	Kapaciteti Motorik	
	Deri në 1600 cm ³	14 000
	Mbi 1 600 cm ³	14.600
Furgona,mikrobuzë	Nr i Vendeve	
	Nga 5 deri në 8 vende	20 300
	Mbi 8 deri në 15 vende	27 900
Autobuzë	Mbi 15 vende	44 400
Kamioncina	Pesha deri ne 3.5 Ton	19 500
Kamiona	Pesha deri në 3.5 Ton	32 600
Rimorkio	Te te gjitha llojeve	9 400
Mjete Bujqesore		7 300
Zjarrfikëse		16 800

3. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Nenit 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, **ritja** dhe **fiksimi** i çmimeve nga të **gjitha** shoqëritë e sigurimit(8 shoqëri) në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar kartel, e cila përbën shkelje të rëndë të nenit 4, pika 1, gërma a të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (TPL), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës.

- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 22 .03 .2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Rezana Konomi

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R